



Financuar nga
Bashkimi Evropian



BULETIN INFORMATIV | NEWSLETTER

Reagimi Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore Institutional Response to Gender-Based Violence

Më 14 tetor 2025, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) organizoi prezantimin e raportit ***"Vlerësimi i sfidave dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në sistemin e kujdesit parësor shëndetësor në Shqipëri."***

Ky studim analizon mënyrën se si sistemi i kujdesit parësor shëndetësor i përgjigjet rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke identifikuar barrierat ekzistuese dhe duke ofruar rekomandime për përmirësimin e shërbimeve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional.

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit "Avancimi i Barazisë Gjinore përmes Mbikëqyrjes dhe Raportimit në Shqipëri (AGORA)", me mbështetjen e Bashkimit Evropian, zbatuar nga GADC në partneritet me Together for Life (TFL) dhe Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA).

On October 14, 2025, the Gender Alliance for Development Center (GADC) organized the presentation of the report ***"Assessment of Challenges and Institutional Response to Gender-Based Violence in Primary Health Care Services in Albania"***

The study provides a comprehensive analysis of how the primary health care system in Albania responds to cases of gender-based violence, identifying structural, legal, and cultural barriers, and offering practical recommendations to improve services and strengthen inter-institutional cooperation.

The event was held within the framework of the project "Advancing Gender Equality through Oversight and Reporting in Albania (AGORA)," supported by the European Union and implemented by GADC in partnership with Together for Life (TFL) and the Institute of Romani Culture in Albania (IRCA).



MIRELA ARQIMANDRITI

Drejtoreshë Ekzekutive | Executive Director
Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"
Gender Alliance for Development Center

Në fjalën e saj hapëse, znj. Mirela Arqimandriti uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrësve dhe theksoi rëndësinë e trajtimit të dhunës me bazë gjinore si një çështje madhore e të drejtave të njeriut, me ndikim të thellë në shëndetin publik, pabarazitë sociale dhe jetën e grave dhe vajzave në Shqipëri. Ajo nënvizoi se dhuna me bazë gjinore mbetet ende e nënraportuar dhe se shumë viktime vazhdojnë të vuajnë në heshtje.

Znj. Arqimandriti vuri theksin tek roli i shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, të cilat shpesh janë kontakti i parë i viktimave me institucionet dhe një pikë kyçe për identifikimin, dokumentimin dhe referimin e rasteve. Ajo theksoi se, sipas Konventës së Stambollit, një reagim efektiv kërkon qasje të integruar që përfshin parandalimin, mbrojtjen e viktimave, ndjekjen penale të autorëve dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërinstytucional.

"Dhuna me bazë gjinore është një shkelje e drejtave themelore të njeriut, dhe ka pasoja të rënda për individët, familjet dhe komunitetin në tërësi." – tha znj. Arqimandriti.

Ajo shprehu mirënjohjen për mbështetjen e Bashkimit Evropian përmes projektit AGORA, falë të cilit u realizua vlerësimi dhe organizimi i kësaj konference. Znj. Arqimandriti inkurajoi pjesëmarrësit të angazhohen aktivisht, të ndajnë përvoja dhe të kontribuojnë në identifikimin e zgjidhjeve praktike që do të forcojnë reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore.

Në mbyllje, ajo theksoi se vetëm përmes angazhimit të përbashkët mund të ndërtojmë një Shqipëri më të sigurt, më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë.

In her opening remarks, Ms. Mirela Arqimandriti welcomed all participants and emphasized the importance of addressing gender-based violence as a major human rights issue, with profound implications for public health, social inequalities, and the lives of women and girls in Albania. She highlighted that gender-based violence remains underreported and that many victims continue to suffer in silence.

Ms. Arqimandriti underscored the crucial role of primary health care services, which are often the first point of contact for victims and a key entry point for identifying, documenting, and referring cases. She stressed that, in line with the Istanbul Convention, an effective response requires an integrated approach that includes prevention, protection of victims, prosecution of perpetrators, and strong inter-institutional cooperation.

"Gender-based violence is a violation of fundamental human rights and has serious consequences for individuals, families, and the community as a whole," said Ms. Arqimandriti.

She expressed her gratitude for the support of the European Union through the AGORA project, which made this assessment and conference possible. Ms. Arqimandriti encouraged participants to engage actively, share their experiences, and contribute to identifying practical solutions that will strengthen the institutional response to gender-based violence.

In closing, she emphasized that only through joint commitment can we build a safer, fairer, and more equal Albania for everyone.



DENADA SEFERI

Zv. Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Deputy Minister of Health and Social Protection

Zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale znj. Seferi theksoi rëndësinë e aktiviteteve të organizuara në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, duke nënvizuar angazhimin e Shqipërisë për një shoqëri të sigurt dhe të barabartë për çdo grua dhe vajzë. Ajo u shpreh se dhuna, si fizike ashtu edhe virtuale, mbetet një sfidë serioze dhe se është thelbësore të parandalojmë shndërrimin e dhunës online në dhunë në jetën reale. Në fjalën e saj, zv. ministrja vuri në dukje se Shqipëria ka kaluar nga iniciativa të mbështetura nga donatorët në një sistem të qëndrueshëm shtetëror, plotësisht të harmonizuar me Konventën e Stambollit. Ajo theksoi funksionalitetin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) në të 61 bashkitë e vendit, që garanton reagim shumësektorial dhe mbështetje të integruar për viktimat.

Zv. ministrja prezantoi statistikën kryesore mbi shërbimet ekzistuese:

- 37 shërbime sociale të specializuara në të gjithë vendin;
- 2 shërbime kombëtare për viktimat e dhunës dhe trafikimit, të financuara në vitin 2025 me 57,740,000 lekë, me 75 përfitues (grua dhe fëmijë);
- 8 qendra rezidenciale afatgjata në Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan;
- 13 qendra emergjente 24–72 orëshe në bashki të ndryshme;
- 3 shërbime rajonale për menaxhimin e krizës dhe 3 qendra komunitare në Kurbin, Lezhë dhe Durrës;
- Përmes Fondit Social: 12 shërbime në 4 bashki dhe 4 qarqe, me rreth 5,500 përfitues, përfshirë 3 sheltera të specializuara rajonale.

Në mbyllje, znj. Seferi bëri një thirrje të qartë dhe gjithëpërfshirëse: *‘Në emër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, i bëj thirrje të gjithë institucioneve, të gjitha bashkive, të gjithë profesionistëve, të rinjve, komuniteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë, të vazhdojmë së bashku, të luftojmë fenomenin e dhunës dhe të ofrojmë gjithë mbështetjen tonë për viktimat e këtij fenomeni.’*

Deputy Minister of Health and Social Welfare, Ms. Seferi, emphasized the importance of the activities organized within the framework of the 16 Days of Activism against Gender-Based Violence, highlighting Albania’s commitment to building a safe and equal society for every woman and girl. She noted that violence—both physical and online—remains a serious challenge, and stressed the need to prevent online violence from escalating into real-life harm. In her remarks, the Deputy Minister underscored that Albania has transitioned from donor-driven initiatives to a sustainable, state-funded system fully aligned with the Istanbul Convention. She highlighted the effectiveness of the Coordinated Referral Mechanism (CRM), which is functional in all 61 municipalities and ensures multisectoral response and integrated support for survivors.

The Deputy Minister presented key statistics on existing services:

- 37 specialized social services operating nationwide;
- 2 national services for victims of violence and trafficking, funded with 57,740,000 ALL in 2025, serving 75 beneficiaries (women and children);
- 8 long-term residential centers in Tirana, Shkodra, Vloera, and Elbasan;
- 13 emergency shelters (24–72 hours) in various municipalities;
- 3 regional crisis-management services and 3 community centers in Kurbin, Lezhë, and Durrës;
- Through the Social Fund: 12 services across 4 municipalities and 4 regions, supporting approximately 5,500 beneficiaries, including 3 specialized regional shelters.

In closing, Ms. Seferi issued a clear and inclusive call to action: *“On behalf of the Ministry of Health and Social Welfare, I call on all institutions, all municipalities, all professionals, young people, communities, and international partners to continue working together, to combat the phenomenon of violence, and to provide our full support to the survivors of this phenomenon.”*



SH.T. SILVIO GONZATO

Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri
EU Ambassador to Albania

Dhunë ndaj grave dhe vajzave mbetet një sfidë globale. Luftimi i dhunës me bazë gjinore kërkon veprim të koordinuar dhe alokimin e burimeve të mjaftueshme. Të gjithë aktorët duhet të veprojnë mbi rekomandimet e raportit dhe të ndihmojnë në zbatimin e protokolleve praktike, të orientuara te të mbijetuarit. BE-ja mbetet e përkushtuar të mbështesë Shqipërinë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor më të fortë e gjithëpërfshirës që vë përparësi barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut.

Violence against women and girls remains a global challenge. Tackling gender-based violence requires coordinated action and the allocation of adequate resources. All stakeholders should act on the recommendations of the report and help implement practical, survivor-focused protocols. The EU remains committed to supporting Albania in building a stronger, more inclusive health system that prioritizes gender equality and human rights.

ETLEVA SHESHI
Drejtoresha e Barazisë Gjinore | Director of Gender Equality
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Ministry of Health and Social Welfare



Në fjalën e saj, znj. Etleva Sheshi theksoi rëndësinë që kanë trajnimi dhe ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të punonjësve të kujdesit shëndetësor për të garantuar një reagim efektiv dhe të bazuar në prova ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore. Ajo vuri në dukje se detyrimi ligjor për të raportuar raste të dhunës është një përgjegjësi profesionale dhe morale, e cila duhet mbështetur nga një sistem funksional bashkëpunimi ndërmjet të gjitha institucioneve përkatëse.

Drejtoresha Sheshi nënvizoi gjithashtu se raportimet aktuale vijnë kryesisht nga policia, pasi punonjësit e shëndetësisë shpesh ndihen të pasigurt për të ndërmarrë hapa të tillë, çka tregon nevojën për një koordinim më të mirë ndër-institucional dhe një qasje të integruar mes të gjithë aktorëve për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe referimit.

In her remarks, Ms. Etleva Sheshi emphasized the importance of continuous training and capacity-building for primary health care workers in order to ensure an effective, evidence-based response to cases of gender-based violence. She highlighted that the legal obligation to report violence is both a professional and moral responsibility, which must be supported by a functional system of cooperation among all relevant institutions. Director Sheshi also noted that most current reports originate from the police, as health workers often feel uncertain about taking such steps. This, she stressed, demonstrates the need for stronger inter-institutional coordination and a more integrated approach among all actors to reinforce protection and referral mechanisms.



JETA DEDA

Drejtor i Përgjithshëm | Director General
Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
Health Care Services Operator

Faleminderit për fjalën dhe për mundësinë për të ndarë disa reflektime mbi rolin e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në përballjen me dhunën me bazë gjinore në nivelin parësor. Kjo është një çështje që kërkon jo vetëm sensibilizim, por mbi të gjitha një reagim të strukturuar institucional. Kujdesi parësor është shpesh pika e parë e kontaktit me sistemin shëndetësor dhe vendi ku një rast dhune mund të identifikohet për herë të parë. Për këtë arsye, reagimi i njësive të Operatorit duhet të jetë i bashkërenduar, i qartë dhe i mbështetur në standarde profesionale.

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga GADC, janë përfshirë gjashtë qarqe, me 194 profesionistë të intervistuar. Kjo bazë na ofron një panoramë reale të situatës: ndërgjegjësim i mirë, por nevojë për forcim të kapaciteteve praktike, përmirësim të rrugëve të referimit dhe komunikim më efektiv ndër-institucional.

Operatori ka ndërmarrë disa hapa konkretë. Së pari, standardizimin e rrugës së referimit me udhëzues praktikë për çdo profesionist. Së dyti, përgatitjen e programeve periodike të trajnimit me module mbi identifikimin e hershëm, komunikimin e ndjeshëm ndaj traumës dhe menaxhimin e sigurt të informacionit. Së treti, caktimin e pikave fokale në çdo NJVKSH për bashkëpunim me strukturat sociale dhe Policinë e Shtetit. Së katërti, përfshirjen e treguesve matës për identifikimin, referimin dhe kohën e reagimit. Së fundi, përmirësimin e hapësirave të pritjes dhe konfidencialitetit.

Burimet njerëzore në shëndetësi janë dinamike, ndaj trajnimi duhet të jetë i vazhdueshëm. Falënderoj GADC për profesionalizmin, Bashkimin Evropian për mbështetjen dhe organizatat e shoqërisë civile për kontributin e tyre. Qëllimi ynë është që çdo protokoll të kthehet në praktikë, çdo udhëzim në veprim dhe çdo profesionist në një hallkë mbrojtjeje. Si Operator, jemi të përkushtuar që ky reagim të jetë pjesë e pandarë e standardeve tona.

Thank you for the floor and for the opportunity to share a few reflections on the role of the Operator of Primary Health Care Services in addressing gender-based violence at the primary care level. This issue requires not only awareness, but above all a structured and coordinated institutional response. Primary care is often the first point of contact with the health system and the place where a case of violence may be identified for the first time. For this reason, the response of our units must be coordinated, clear and supported by professional standards.

Within the EU-supported project implemented by GADC, six regions were included, with 194 professionals interviewed. This provides a realistic picture of the situation: good awareness, but a need to strengthen practical capacities, improve referral pathways and ensure more effective inter-institutional communication.

The Operator has taken several concrete steps. First, the standardisation of the referral pathway with practical guidelines for every professional. Second, the preparation of periodic mandatory training with modules on early identification, trauma-sensitive communication and safe information management. Third, the designation of focal points on gender-based violence in each local unit, cooperating with social services and the State Police. Fourth, the inclusion of measurable indicators for identification, referral and response time. Finally, improvements in waiting areas and confidentiality.

Human resources in health care are dynamic, so training must be continuous. I thank GADC for their professionalism, the European Union for its support, and civil society organisations for their contribution. Our goal is to turn every protocol into practice, every guideline into action, and every professional into an active link of protection. As the Operator, we remain committed to making this response an integral part of our standards nationwide.



MANUELA BELLO

*Drejtuuese e Zyrës | Head of Office
UNFPA Albania | United Nations Population Fund*

Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut dhe një pengesë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Shëndeti është një nga dimensionet më të prekura nga dhuna — dhe rrjedhimisht, sistemi shëndetësor është edhe një nga sektorët me potencialin më të madh për të ofruar ndihmë të hershme, të sigurt dhe të ndjeshme ndaj traumës.

Nga perspektiva e UNFPA-së, integrimi i parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe mbështetjes për viktimat në shërbimet e shëndetit dhe të drejtave seksuale e riprodhuese është thelbësor.

Kjo nënkupton:

- forcimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë për të ofruar kujdes të ndjeshëm ndaj traumës dhe për të siguruar mbrojtjen e dinjitetit të çdo gruaje dhe vajze.
- zhvillimin e procedurave të qarta për identifikimin, dokumentimin dhe referimin e rasteve.
- dhe garantimin që çdo qendër shëndetësore të jetë një hapësirë e sigurt, konfidenciale dhe pa paragjykim.

UNFPA mbetet e përkushtuar të mbështesë përpjekjet kombëtare për një sistem shëndetësor që mbron, fuqizon dhe promovon të drejtat e grave dhe vajzave, duke e parë këtë si pjesë thelbësore të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të një shoqërie të barabartë për të gjithë.

Violence against women and girls remains one of the most serious violations of human rights and a major obstacle to the country's sustainable development.

Health is one of the dimensions most affected by violence—and consequently, the health system is also one of the sectors with the greatest potential to provide early, safe, and trauma-sensitive support.

From UNFPA's perspective, integrating the prevention of gender-based violence and support for survivors into sexual and reproductive health and rights services is essential.

This entails:

- strengthening the capacities of health professionals to provide trauma-sensitive care and to ensure the protection of the dignity of every woman and girl;
- developing clear procedures for the identification, documentation, and referral of cases;
- and ensuring that every health facility is a safe, confidential, and non-judgmental space.

UNFPA remains committed to supporting national efforts toward a health system that protects, empowers, and promotes the rights of women and girls, viewing this as an essential component of sustainable development and of an equal society for all.





BLEDAR TAHO

Drejtor Ekzekutiv | Executive Director
Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri
Institute of Romani Culture in Albania

Së pari, dëshiroj të falenderoj partnerët GADC dhe TFL, si dhe mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për këtë iniciativë të rëndësishme në raportimin e dhunës me bazë gjinore në shëndetin parësor.

Sot diskutojmë një nga sfidat më të mëdha shoqërore: thyerjen e barrierave që pengojnë individët e marginalizuar, veçanërisht gratë dhe vajzat rome, të jetojnë të lira nga dhuna dhe të kenë akses të barabartë në kujdesin shëndetësor. Pas çdo statistike ka një jetë reale — një grua, një vajzë, një familje — dhe fatkeqësisht dhuna shfaqet në forma fizike, psikologjike, ekonomike dhe institucionale.

Në komunitetet rome dhe egjiptiane, dhuna shpesh mbetet e padeklaruar për shkak të mungesës së mbështetjes, frikës për të raportuar dhe mosbesimit të institucionet. Rreth 60% e grave dhe vajzave rome përballen me vështirësi të mëdha në aksesimin e shëndetit parësor, për shkak të varfërisë, analfabetizmit, izolimit dhe mungesës së informacionit. Këtyre u shtohet edhe diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në kontakt me disa profesionistë shëndetësorë — një realitet i papranueshëm në një vend që synon integrimin evropian.

Kapitujt 19, 23 dhe 24 të BE-së kërkojnë barazi në qasje, mbrojtje nga dhuna dhe shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, që nuk mund të arrihen pa përfshirjen e komuniteteve më të marginalizuara. Thyerja e barrierave nënkupton ngritjen e urave të besimit, trajnimin e profesionistëve dhe fuqizimin e grave rome përmes arsimit dhe njohjes së të drejtave të tyre.

IRCA punon çdo ditë duke ofruar informim, mbështetje, ndërgjegjësim dhe bashkëpunim me institucionet. Nuk mund të flasim për barazi apo drejtësi pa garantuar që gratë rome të kenë mundësi të kërkojnë ndihmë dhe të raportojnë dhunën. Thyerja e barrierave është thirrje për veprim dhe solidaritet për një Shqipëri ku çdo person ndihet i mbrojtur, i respektuar dhe i barabartë.

First, I would like to thank our partners GADC and TFL, as well as the support of the European Union and the Ministry of Health and Social Protection for this important initiative in reporting gender-based violence in primary health care.

Today we are discussing one of the greatest social challenges: breaking the barriers that prevent marginalized individuals, especially Roma women and girls, from living free from violence and having equal access to health care. Behind every statistic there is a real life — a woman, a girl, a family — and unfortunately, gender-based violence appears in physical, psychological, economic, and institutional forms.

In Roma and Egyptian communities, violence often remains unreported due to lack of support, fear of reporting, and mistrust in institutions. Around 60% of Roma women and girls in Albania face serious difficulties in accessing primary health care, due to poverty, illiteracy, isolation, and lack of information. Added to this is direct and indirect discrimination in contact with some health professionals — a reality that is unacceptable in a country aiming for European integration.

EU negotiation Chapters 19, 23 and 24 require equality in access, protection from violence, elimination of discrimination, and inclusive health care services, which cannot be achieved without including the most marginalized communities. Breaking barriers means building bridges of trust, training professionals, and empowering Roma women through education, health awareness, and knowledge of their rights.

IRCA works every day by providing information, support, awareness, and cooperation with institutions. We cannot speak about equality or justice if Roma women do not have the opportunity to seek help or report violence.

Breaking barriers is a call for action and solidarity for an Albania where every person feels protected, respected, and equal in dignity and rights.



EGLANTINA BARDHI

*Drejtoreshë Ekzekutive | Executive Director
Shoqata "Together for Life"*

Drejtoresha Ekzekutive e TFL, znj. Eglantina Bardhi, theksoi se lufta kundër dhunës me bazë gjinore nuk mund dhe nuk duhet të mbetet përgjegjësi e një aktori të vetëm, por kërkon një përgjegjësi të përbashkët dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe mediave. Ajo nënvizoi se vetëm përmes koordinimit të qëndrueshëm dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit mund të ndërtohet një përgjigje efektive dhe e ndjeshme ndaj nevojave të viktimave.

"Megjithatë, u shpreh znj. Bardhi, "roli i institucioneve shtetërore është vendimtar, veçanërisht ai i sistemit shëndetësor brenda mekanizmit të referimit. Sistemi shëndetësor shpesh është pika e parë e kontaktit për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë, ndaj kërkohet një angazhim i vazhdueshëm për forcimin e kapaciteteve profesionale, përmirësimin e procedurave dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, në mënyrë që reagimi të jetë i koordinuar, i sigurt dhe i përqendruar te viktimat."

The Executive Director of TFL, Ms Eglantina Bardhi, emphasised that the fight against gender-based violence cannot and should not remain the responsibility of a single actor, but requires shared responsibility and close cooperation between state institutions, civil society and the media. She underlined that only through sustained coordination and continuous exchange of information can an effective and sensitive response to the needs of victims be built.

"However," Ms Bardhi stated, "the role of state institutions is decisive, particularly that of the health-care system within the referral mechanism. The health-care system is often the first point of contact for women and girls who experience violence, therefore continuous commitment is required to strengthen professional capacities, improve procedures and increase institutional accountability, so that the response is coordinated, safe and victim-centred."





Gjetjet Kryesore | Main findings

- Rastet e DHBGJ-së nga mjekët dhe infermierët e kujdesit shëndetësor parësor shfaqen rrallë ose nuk raportohen për shkak të kufizimeve në identifikim dhe raportim.
- Pjesa më e madhe e profesionistëve të shëndetësisë kanë njohuri mbi dhunën me bazë gjinore dhe format e dhunës familjare, por vetëm 80% mendojnë se DHBGJ është më e shpërndarë në sektorin e shëndetësisë.
- Ndjesia e përgjegjësisë profesionale për të raportuar dhunën me bazë gjinore është e lartë (80%), por vetë përvoja e raportimit është e ulët (40%).
- Rreth 60% e profesionistëve vlerësojnë se procedurat për raportimin e rasteve janë të qarta dhe të zbatueshme, ndërsa 40% e tyre gjënë shumë të vështira për t'u aplikuar në praktikë.
- Ka mungesë trajnimesh mbi ofrimin e mbështetjes emocionale dhe menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke kërkuar trajnime më të thelluara.
- Vetëm 17.8% e profesionistëve identifikuan Mekanizmin e Kordinuar të Referimit (MKR) si detyrimi ligjor dhe institucional dhe vetëm 37% përdorin udhëzuesin Kombëtar për Dhunën me Bazë Gjinore.
- Dokumentacioni standard i referimit përfshihet në formularin e regjistrimit; 20% formojnë referime për raste në familje dhe profesionistë të tjerë të sistemit.
- Mungesa e udhëzimeve të qarta, formularëve standard dhe procedurave operative është një problem i rëndësishëm për vetëm 34% që e konsiderojnë sistemin të sigurt për raportime konfidenciale.
- Gender Based Violence cases identified by primary health care doctors and nurses are rare or not reported due to limitations in identification and documentation.
- Most health professionals have knowledge about gender-based violence and its forms, but only 80% believe that GBV is prevalent in the health sector.
- The sense of professional responsibility to report gender-based violence is high (80%), but actual reporting experience is low (40%).
- About 60% of professionals consider reporting procedures to be clear and applicable, while 40% find them very difficult to apply in practice.
- There is a lack of training on providing emotional support and managing gender-based violence cases, requiring more in-depth training.
- Only 17.8% of professionals identified the Coordinated Referral Mechanism (CRM) as a legal and institutional obligation, and only 37% use the National Guideline on Gender-Based Violence.
- Standard referral documentation is included in the registration form; 20% make referrals to family or other professionals within the system.
- The lack of clear guidelines, standard forms, and operational procedures is a significant issue, while only 34% consider the system safe for confidential reporting.






Gjetjet Kryesore | Main findings

- Normat shoqërore janë barrierat kryesore për gratë në komunitete rurale dhe qytetare, sugjerojnë që presioni për të ruajtur imazhin familjar janë barrierat kryesore për të kërkuar ndihmë, duke fshehur dhunën dhe duke kufizuar ndërhyrjen e profesionistëve.
- Mungesa e besimit në institucionet publike, përvojat negative dhe frika nga hakmarrja pengojnë gratë të raportojnë.
- Kultura e mosndërhyrjes, mungesa e sinjaleve të brendshme dhe klimë jo e shpërblyer kontribuojnë në pamundësinë për të ofruar një përgjigje të koordinuar dhe të besueshme nga sistemi.
- Studimi tregon mungesë në qartësinë në protokollat dhe dokumentet udhëzuese për menaxhimin e rasteve të dhunës së bazuar në gjini, duke ndikuar në efikasitetin e shërbimeve.
- Punonjësit psikosocialë shpesh mbështeten në iniciativa personale për të mbushur boshllëqet në udhëzimet dhe mjetet, duke ekspozuar boshllëqet në cilësinë e shërbimit.
- Trajnimet e rregullta dhe praktike në komponentë interaktive si simulime dhe diskutime rreth rasteve mungojnë, duke bërë që profesionistët të ndihen të papërgatitur për situata delikate.
- Komunikimi midis aktorëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit është i dobët dhe informal, duke përdorur kanale të papërcaktuara si thirrjet telefonike dhe mesazhe personale, duke rritur pasigurinë, ndërprerjet dhe mungesën e përgjegjshmërisë institucionale.
- Social norms are the main barriers for women in rural and urban communities; pressure to preserve family image remains a key obstacle to seeking help, hiding violence, and limiting professionals' interventions.
- Lack of trust in public institutions, negative experiences, and fear of retaliation prevent women from reporting.
- The culture of non-interference, lack of internal signals, and an unrewarding work climate contribute to the inability to provide a coordinated and trustworthy response from the system.
- The study shows a lack of clarity in the protocols and guiding documents for managing gender-based violence cases, affecting the effectiveness of services.
- Psychosocial workers often rely on personal initiatives to fill gaps in guidance and tools, exposing inconsistencies in service quality.
- Regular and practical trainings with interactive components such as simulations and case discussions are missing, leaving professionals unprepared for sensitive situations.
- Communication among actors of the Coordinated Referral Mechanism is weak and informal, using undefined channels such as phone calls and personal messages, which increases uncertainty, interruptions, and lack of institutional accountability.





Financuar nga
Bashkimi Evropian



Gender Alliance for Development Center

Address: Str. Abdyl Frashëri, Pall 10/1
Tirana, Albania

Phone: +355 4 22 555 14

Mob: +355 68 20 59 301


Web: <https://gadc.org.al/>

Follow us in Social Media

 <https://www.facebook.com/GADCAbania/>

 https://www.instagram.com/gadc_albania/

 <https://www.linkedin.com/company/88447095>

 <https://www.youtube.com/channel/UCUZJnKqwQ0cURSqKPc1NaXQ>